Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- 
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>“SHËRBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER DREJTORINE VENDORE TE POLICISE TIRANE”</b>						
<b>Nr .</b>	<b>EMERTIMI</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia e pritshme e racioneve</b>	<b>Cmimi per njësi Lekë (pa TVSH)</b>	<b>Vlera e pritshme Leke (pa TVSH)</b>	<b>Afati I marreveshjes kuader</b>
<b>1</b>	Ushqim i gatuar e shperndare	rd	27,927			
<b>Fondi i marreveshjes kuader (Leke pa tvsh)</b>					<b>17,808,629</b>	
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						

---

<b>Vula</b>		
<b>Datë</b> _____		

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE E USHQIMI”**

1. Operatori Ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
2. Produktet ushqimore, lënda e parë, që do të përpunohen, trajtohen apo ambalazhohen në ambientet e kuzhinës që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse.
3. O.E. duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmshëmrisë së tij sipas VKM-së Nr.760 datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshët përgjatë ushqimit ushqimor” dhe analizave të ujit që përdor.
4. Magazinimi i lëndës së parë duhet të bëhet në dy forma:
  - a. Në temperaturë ambjenti
  - b. Në frigorifer ose dhoma frigoriferike
    - Magazinimi në temperaturë ambjenti bëhet në dollape/rafte metalike të lyera me ngjyrë të qartë në ambiente të destinuara ekskluzivisht për depozitimin e ushqimeve. Këto mjete janë të lashme për të thjeshtuar operacionet e pastrimit të sipërfaqeve. Këto mjete janë bërë në mënyrë të tillë që të mos lihen volume bosh ose vende që mund të përbëjnë sipërfaqe kolonizimi nga insektet ose mikrobet.
    - Magazinimi në frigorifer ose dhomë frigoriferike bëhet në temperatura të ndryshme në funksion të produktit që konservohet duke filluar nga temperatura maksimale +5°C deri në -22°C. Të gjithë frigoriferët duhet të kenë një display të jashtëm me treguesit e temperaturës.
    - Vazhdimësia e energjisë elektrike tek motorët e frigoriferëve duhet të jetë e garantuar me gjeneratorë në pronësi të kompanisë.
    - Kushtet higjienike të lëndës së parë në fazën e stokimit duhet të jenë nën kontrollin e përgjegjësit të magazinës.
5. Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 date 28.01.2008 “Per Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.
6. Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standarteve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetkontrollit të HACCP.
7. Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e vecanta deri te konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posaçme ( termuse) tëellojeve dhe të madhesive të ndryshme në funksion të sasise që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit ( e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit të produktit )
8. Produktet ushqimore (lënda e parë) që do të përpunohen , trajtohen apo ambalazhohen në ambientet e përpunimit ( kuzhines ) që disponon sipërmarrësi do të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse
9. Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjienës për larjen, pastrimin dhe përpunimin e zarzavateve, frutave , sipas kërkesave të ligjeve në fushën e higjienës dhe ushqimit.

- 
10. Operatori për qëllime higjienë dhe pastrimi të përdorë detergjente dhe solucione kimike të certifikuar nga institucionet e njohura me ligj dhe të padëmshme për shëndetin e njerëzve të përcaktuara sipas akteve përkatëse ( Urdhëri Nr. 365 dt. 03.08.2012 i Ministrisë të Shëndetësisë “ Për miratimin e listës dhe përdorimin e lendeve që përdoren për dezinfektim , deratizim dhe insektim në shëndet publik”)
  11. Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjienë të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhines, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave.
  12. Operatori duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren. Pastrimi i inventarit të imët kryhet nga operatori ekonomik, i cili duhet të mbajë dhe rregjistrat e pastrimit.
  13. Në rast të sëmundjeve infektive, të përdoren për shpërndarje të ushqimit vetëm pajisje të vecanta dhe një përdorimeshe.
  14. Operatori ekonomik, do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultat i prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit, në vendet e caktuara si vend grumbullimi mbeturinash.
  15. Materiali në kontakt me ushqimin ( termuset , enët etj me të cilat transportohet ushqimi ) të jenë material i përshtatshëm dhe lehtësisht të pastrueshëm , sipas kërkesave të Udhezimit të Ministrisë të Bujqësisë Nr. 22 , datë 25.11.2010 “ Kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor “, me mbyllje hermetike ( për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm) . Enët që përdoren për transportin dhe /ose shpërndarjen e ushqimit duhet të jenë me material jo të demshëm për shëndetin.
  16. Punonjësit e operatorit ekonomik në momentin e përgatitjes / shërbimit të ushqimit në ambientet e autoritetit kontraktor , duhet të jenë pajisur me uniformën , veshjen përkatëse të punës ( përparëse , grykëse , kepuce pantallona) , këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.
  17. Operatori ekonomik duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plote të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjet gjurmueshmërisë së tij, sipas VKM Nr. 760, datë 16.09.2015 “ Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor” dhe analizave të ujtit që përdor .
  18. Operatori ekonomik është i detyruar të ruajë në raftet të vecanta në mjedisin e kuzhines, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrenie për të gjitha vaktet. Afati i ruajtjes së mostrave (kampionëve ) është 24 – ore. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave.
  19. Operatori ekonomik, do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit të gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

**Nga Operatori ekonomik privat kërkohet të plotësohet:**

Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimorë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.189, datë 15.03.2017 "Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit si dhe shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre, normave e kalorive përkatëse të miratuara në Udhezimin të përbashkët të Ministrisë së Brendshme me Nr.942 , datë 03.10.2017 dhe të Ministrisë së Shëndetësisë Nr.4130 datë 05.10.2017 “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, studentëve dhe kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar deri në sqarimin e pozitës së

tyre “, Pasqyra Nr.4 “Norma e ushqimore për shtetasit e ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre ( të huaj dhe shqiptarë”.

Sipërmarresi është i detyruar të sigurojë të gjitha orëditet e pajisjet që nevojiten, për transport, shpërndarje dhe serviranje.

Kontraktuesi duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave të miratuara në pasqyrën Nr.4 të Normave të ushqimit sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.

---

Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse të miratuara në Udhezimin të përbashket të Ministrisë së Brendshme me Nr.942 , date 03.10.2017 dhe të Ministrisë së Shendetësisë Nr.4130 datë 05.10.2017 “Per miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjesve të Policise se Shtetit, studentëve dhe kursantëve ne institucionet arsimore te Policisë se Shtetit si dhe te shtetasve të ndaluar ose te arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre “, Pasqyra Nr.4 bashkëlidhur “Norma e ushqimore për shtetasit e ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre ( të huaj dhe shqiptarë”.

Sipermarresi eshte i detyruar te siguroje te gjitha orendite e pajisjet qe nevojiten, per transport, shperndarje dhe servirje, si dhe pajisje per ruajtje te zakonshme dhe ne kushte frigoriferike ne ambientet e Komisariateve e DVP Tirane ku serviret ushqimi.

Zarzavatet duhet te përdoren gjithmonë te freskëta dhe asnjëherë te konservuara si dhe duhet te plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH te shoqëruara me flete analize përkatëse.

Sigurimin e te gjithë artikujve ushqimore sipas normave e kalorive përkatëse te miratuara ne urdhrat dhe VKM.

Mishi duhet te jete mish viçi i freskët, cilësia e pare dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar, bazuar ne STASH.

Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë javore të ushqimit të miratuar, konformë normës bazë të ushqimit e cila duhet të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normës bazë të ushqimi.

Sherbimi do te serviret në vartësi të numrit të të ndaluarve, sipas orarit te percaktuar per te tre vaktet e ngenies se ushqimit ne DVP Tiranë dhe në Komisariatet Nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Vore sipas vendndodhjeve te tyre.

Shpërndarja e ushqimit deri tek te ndaluarit ne çdo Komisariat Policie do te behet me pajisje te përshtatshme te ambalazhuara bazuar ne specifikën qe mbart ky sherbim per persona te ndaluar Ushqimi te serviret i ngrohete per çdo vakt sipas orarit te percaktuar.

- Mengjesi ora 07.00 - 09.00,
- Dreka ora 12.00-13.30,
- Darka ora 18.00-20.00.

Në momentin e dorëzimit të ushqimit në prezencë të dorëzuesit dhe pranuesit të ushqimit ndahet një moster ushqimi e cila ruhet ne ambientet e sistemit te sigurise ne kushte frigoriferike, te siguruar nga ana e kontraktuesit (firmes fituese),

Afati i ruajtjes së kampioneve është 24 orë dhe vulozet nga mjeku dhe oficeri i rojës.

Sipërmarrësi me anë të strukturave përkatëse do të rakordojë me Sektorin Ekonomik çdo muaj për racionet ditore te porositura sipas normave përkatëse, te bazuara ne raport forcat e uahqimit te lëshuara nga Shefi i Salles se Komandimit ne Drejtorine Vendore e Policise Tirane per Aparatin e Drejtorise dhe per Komisariatet ne vartesi te saj.

Ushqimi i gatuar sipas normave, te shoqërohet me dokument dalje ditore per Drejtorine Vendore te Policise dhe Komisariatet vartese.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t’i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menisë javore.

Produktet ushqimore dhe ushqimi i gatuar nga operatori ekonomik do t’i nënshtrohet kontrolleve nga Autoriteti Kontraktor duke ju referuar specifikimeve teknike të tyre për cilësinë, sasinë dhe normën sipas menisë javore.

Furnizimi me uje, energji, gaz.

a) Furnizimi me uje, enegji, gaz do te kryhet ne baze te kontratave te lidhura nga kontraktuesi dhe ndermarrjet perkatese furnizuese. Per te garantuar vazhdimesine e sherbimit eshte e nevojshme

b) Ne rast nderpreje te burimeve te furnizimit, te vere ne dispozicion burime alternative furnizimi me keto sherbime me mareveshje midis paleve.

c) Sipërmarrësi qe do te kryej ketë shërbim, duhet te lidhe kontrate për energjinë dhe ujin e pijshëm, me institucionet përkatëse (OSHEE dhe Ujësjellësin ) duke zbatuar te gjitha rregullat dhe udhëzimet nga institucionet përkatëse.

#### IV. SHËRBIMET

##### NORMA PER NJE RACION DITOR

Nr	Artikujt ushqimor	Njesia matjes	Norma ditore ne kg
a	b	c	1
1	Buke gruri	kg	0.4
2	Oriz	kg	0.04
3	Makarona	kg	0.04
4	Fasule	kg	0.04
5	Mish viçi	kg	0.08
6	Vaj	kg	0.03
7	Sheqer	kg	0.02
8	Djath i bardhe	kg	0.04
9	Qumesht i fresket	kg	0.25
10	Veze	kokerr	1
11	Perime gatimi + sallate	kg	0.3
12	Fruta (molle + portokalle)	kg	0.2
13	Salce	kg	0.004
14	Çaj mali	Kg	0.002
15	Kripe	Kg	0.005

#### **Shërbimi që kërkohet:**

Sherbimi do te serviret në vartësi të numrit të të ndaluarve dhe te arrestuarve , sipas orarit te percaktuar per te tre vaktet e ngenies se ushqimit ne DVP Tiranë dhe në Komisaritet Nr.1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Vore sipas vendndodhjeve te tyre.

#### **GRAFIKU I LEVRIMIT**

##### **Afatet e ekzekutimit:**

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: Nga momenti i lidhjes se kontratës deri në 31.12.2024, Sherbimi do te realizohet sipas nevojave(kerkeses) te DVP Tirane per numrin e te ndaluarve dhe te arrestuarve, sipas raport forces te leshuar nga salla e Drejtimit e Komandimit ne DVP Tirane per Drejtorine e Komisaritet , sipas vakteve.

##### **Objektivat:**



- 
- Te siguroje furnizimin ne kohe dhe me cilësinë e kërkuar te ushqimit te gatuar.
  - Te garantoje ne çdo kohe shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas normës për shtetasit e ndaluar dhe te arrestuar.
  - Te siguroje ushqim te sigurte për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet qe mund te shkaktohen nga ushqimi.
  - Të bëjë kompletimin e ambienteve (mense e kuzhine) me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.
  - Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit per te ndaluarit dhe te arrestuarit
  - Te siguroje kushtet e nevojshme higjeno sanitare për realizimin e shërbimit.
  - Te siguroje shërbim me standarde te larta.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

“SHËRBIM GATIMI DHE SHPERNDARJE USHQIMI PER DREJTORINE VENDORE TE POLICISE TIRANE”			
Nr .	EMERTIMI	Njesia	Sasia e pritshme e racioneve
1	Ushqim i gatuar e shperndare	rd	27,927

**Afatet e ekzekutimit:** Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim te afatit 24 muaj, deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë”.

#### Objektivat:

- Te siguroje furnizimin ne kohe dhe me cilësinë e kërkuar te ushqimit te gatuar.
- Te garantoje ne çdo kohe shumëllojshmërinë dhe kaloritë e nevojshme sipas normës për te ndaluarit dhe te arrestuarit.
- Te siguroje ushqim te sigurve për mbrojtjen e shëndetit nga dëmtimet qe mund te shkaktohen nga ushqimi.
- Të bëjë kompletimin e ambienteve (mense e kuzhine) me pajisjet e domosdoshme për furnizimin, përgatitjen, gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit.
- Të sigurojë gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit , sipas vakteve dhe normave
- Te siguroje kushtet e nevojshme hijeno sanitare për realizimin e shërbimit.
- Te siguroje shërbim me standarde te larta.

**Detyrat:** Furnizimi ne kohe, me korrektesi dhe konform specifikimeve te kerkuara.

**Shpërndarja:** Sipas zerave te sherbimit te kerkuar perkatesisht ne Shtojcën 1, Shtojcën 8 dhe Shtojcën 10 të DT.

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Ne DVP Tirane dhe Komisaritet e Policise Nr. 1,2,3,4,5,6 dhe Kom Pol. Vore.

- a. Specifikimet teknike jane pjese integrale e dokumentave te tenderit, te cilat do te plotesohen me cmimet qe ofertuesi do te ofroje. Oferta do te jete ne perputhje me dokumentat e tenderit.
- b. Cdo ofertues duhet te jape cmimet per RD, dhe per cdo artikull sipas zerit
- c. Personi i autorizuar per ndjekien e sherbimit do te jete: Shefi i Seksionit te Sherbimeve ne DVP Tirane.
- d. Operatori ekonomik fitues duhet te siguroje punonjës te kualifikuar dhe me eksperience pune mbi pese vjet si kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier.
- e. Operatori ekonomik merr përsipër kontrata të rregullta pune për personelin e shërbimit duke kryer pagesat e sigurimeve shoqërore.
- f. Të gjithë punonjësit e operatorit ekonomik duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me shenja dalluese përkatëse të shoqërisë.
- g. Operatori ekonomik duhet t'i komplettoj të gjitha mjetet dhe pajisjet me të gjitha shenjat dalluese të shoqërisë.
- h. Operatori ekonomik do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktor konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme ose është mjaft i pakënaqur nga puna e këtij personi.
- i. Personeli do të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.

---

### **Përshkrimi i shërbimeve:**

- Furnizimi i lendes se pare, përgatitja, gatimi dhe shpërndarja e ushqimit për 3 vakte sipas programit ushqimor të përgatitur dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor (Nga Shefi i Sektorit Ekonomik).
- Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin e ushqimit sipas normave.
- Sigurimin e të gjithë artikujve ushqimore sipas sasisë e kalorive përkatëse të miratuara.
- Nuk lejohet në asnjë rast dhe për asnjë arsye zëvendësimi nga operatori ekonomik i artikujve ushqimorë që janë të përcaktuara në normën bazë të ushqimit dhe menunë javore pa miratuar nga Autoriteti kontraktor.
- Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menuse konformë normave bazë të ushqimit.
- Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë dhe kaloritë e duhura sipas normave bazë të ushqimit

### **Programi Ushqimor**

- Llojshmëria e ushqimit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara nga programi dhe menuja e përgatitur nga shërbimi i ushqimit dhe i shëndetësisë të DVP TIRANE në bazë të normave.
- Ky program ushqimor do të ketë dhe konfirmimin e sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menuse ditore të ushqimit sipas programit të miratuar nga DVP Tirane.
- Shërbimi do te realizohet sipas nevojave (kerkeses) te DVPTirane per numrin e te ndaluarve dhe te arrestuarve sipas raport forces te leshuar nga salla e drejtimit e komandimit per te 3 vaktet ditore.

---

## Shtojca 8

### “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR DREJTORINE VENDORE TE POLICISE, TIRANE.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

#### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

##### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

#### **Shënim 1.1:**

Operatori ekonomik në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, konkretisht neni 19, për çdo stabiliment që disponon (pronësi dhe/ose qira) të paraqesë tabelën me informacion si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Vendodhja</b>	<b>Statusi</b>	<b>Nr. i regjistrimit të posacem</b>
1		Pronësi/qira/perdorim	
Etj.		Pronësi/qira/perdorim	

Detyrimisht duhet që çdo stabiliment duhet të jetë i pajisur me licence perkatëse. Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këtë nen do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave perkatëse administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”.

#### **Shënim 1.2:**

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AKU jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacione e kërkuar për çdo stabiliment (në pronësi dhe/ose qira).

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, brenda Qarkut në të cilin do të kryhet shërbimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

### ➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

### ➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

### ➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

**Shënim 2.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohej plotësimi i standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (mijete) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targen e mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi ose me qira

## Shënim 3.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacionin për mjetin e

mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimi të mjetit.

**Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

4. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt procurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/teknolog)	1
2.	Kuzhinier	2
5.	Ndihmes Kuzhinier	2
6.	Punonjes shperndares ushqimesh	2
	<b>Total</b>	<b>7</b>

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

**a) Për drejtuesin teknik të paraqitet:**

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Mercollog/Kimist/Teknolog.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale të leshuar nga e - albania.
- Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklarata perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklarata perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.

**b) Për Kuzhinierin të paraqitet:**

- Diplome ose certifikatë kualifikimi.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale të leshuar nga e - albania.

**c) Për ndihmes kuzhinier të paraqitet:**

- Kontrate pune.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale të leshuar nga e - albania.

**d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi, të paraqitet:**

- Kontratë pune.
- Leje drejtimi mjeteve kategorisë – B.

- Operatori ekonomik të paraqes deklarata në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
----	--------------	------------	---



---

**Shënim 4.1:** Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

**Shënim 4.2:**

Me qellim garantimin e gjithe perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

**Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Shënim 5.1:** Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës me autoritetin kontraktor ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se mundëson transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në vendet e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas percaktimeve ligjore ne fuqi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

